

GJËNDJA ME BARAZINË GJINORE NË TREGUN E PUNËS NË RAJONIN E POLLOGUT

3


SA JANË AFËRSISHT TË ARDHURAT TUAJA MUJORE NË FAMILJE?

	Më pak se 8000	8001–18000	18001–30000	30001–60000	60001 +	Refuzon të përgjigjet	Nuk e di
Bogovinjë	0,0%	15,2%	12,1%	0,0%	0,0%	39,4%	33,3%
Брвеница	0,0%	21,4%	32,1%	25,0%	7,1%	14,3%	0,0%
Gostivar	1,9%	20,8%	33,0%	17,9%	8,5%	14,2%	3,8%
Jegunovcë	0,0%	0,0%	81,8%	18,2%	0,0%	0,0%	0,0%
Mavrovë dhe Radostushë	23,1%	38,5%	30,8%	7,7%	0,0%	0,0%	0,0%
Tearcë	31,3%	46,9%	6,3%	6,3%	6,3%	0,0%	3,1%
Tetovë	4,7%	11,6%	11,6%	32,6%	20,9%	16,3%	2,3%
Vrapçishtë	0,0%	11,1%	16,7%	5,6%	11,1%	33,3%	22,2%
Zhelinë	11,9%	64,3%	4,8%	14,3%	0,0%	0,0%	4,8%


- Mbi 50% e familjeve në Rajonin e Pollogut janë me pesë ose më shumë anëtarë, ndërkohë që 1/3 e tyre jetojnë me të ardhurra mujore deri në 18.000 denarë.
- Përveç se nga punësimi, 21% e familjeve realizojnë të ardhura nga puna honorare, dhe 17% fitojnë para nga të afërmit që punojnë jashtë shtetit.

GRATË JANË TË PAPUNËSUARA, VEÇANËRISHT NË ZONAT RURALE


Niveli i papunësisë në Rajonin e Pollogut në vitin 2014



NUMRI I BURRAVE NË FAMILJE TË PUNËSUAR



NUMRI I GRAVE NË FAMILJE TË PUNËSUARA



Gjetjet nga anketa tregojnë se në 45% e familjeve, gratë mbi 18 vjeç janë të papunësuar kundrejt 17,3% të burrave.

GRATË JANË TË VARFËRA EDHE KUR JANË TË PUNËSUARA

TË ARDHURA MESATARE MUJORE NË FAMILJE SIPAS NUMRIT TË GRAVE TË PUNËSUARA

		Gra të punësuar nga familja				
		Nuk ka gra të punësuar nga familja	1	2	3	4
Sa janë afërsisht të ardhurat tuaja mesatare mujore në familje?	Më pak se 8000	13,3%	1,8%	0,0%	0,0%	0,0%
	8001-18000	38,7%	13,7%	13,3%	0,0%	0,0%
	18001-30000	16,0%	25,6%	28,9%	0,0%	0,0%
	30001-60000	6,1%	25,6%	22,2%	100%	0,0%
	60001+	1,7%	13,1%	17,8%	0,0%	100%
	Refuzon të përgjigjet	12,2%	16,7%	17,8%	0,0%	0,0%
	Nuk e di	12,2%	3,6%	0,0%	0,0%	0,0%

FEMINIZIMI I VARFËRISË?

50% e grave të papunësuar jetojnë në familje me të ardhura të ulëta. Diçka më pak se 1/3 e familjeve në të cilat ka një ose dy gra të punësuar, jetojnë me të ardhura mujore deri në 18.000 denarë.

SIPËRMARRJA E GRAVE ËSHTË NË FILLIMET E SAJ

Në të gjitha komunat e Rajonit, përveç se në Zhelinë, ka aktivitete për inkurajimin e sipërmarrjes së grave dhe ekziston trendi për formalizimin e bizneseve. Ka përparime, por ka edhe kufizime të cilat i demotivojnë gratë: njohuri dhe shkathhtësi për planifikim të biznesit, parakushte për realizimin e ideve të tyre.

BIZNESET E GRAVE JANË JOFORMALE, TË VOGLA DHE TË STEREOTIPIZUARA NË ASPEKTIN GJINOR

Baxho qumështi – është ndërmarje e madhe ku pronare është grua, ka mjaft firma për gatimushqimi, butiqe, zanate - parukere, robaqepëse.“

Shitje kiflesh dhe gjërash të tjera të ngjashme është aktivitet që dominon.“


Ato nuk janë të rregjistruara.“

...kam plan të hap një zyrë avokatie, megjithatë do të duhet të heq dorë nga lindja e fëmijëve. (qesh). Përse? Tek ne, anjsë avokate shtatzënë nuk shkon në gjyq. Kush do t'a rruajë fëmijën 9 muajt ose një vit që vijojnë, edhe me një fëmijë plus? D.m.th. s'ka shanse.“

...çfarëdojloj biznesi që të fillosh të nevojiten mjete financiare. Edhe të kërkosh peng nga banka, patjetër duhet ta vësh nën hipotekë ndonjë pasuri, a gratë që kanë diçka për ta vënë nën hipotekë që të mund të marrin një sasi parash/ kredi nga banka për të filluar ndonjë biznes janë shumë të rralla. Domethënë, gjithçka që posedohet në martesë, më së shumti i përket burrit.“

GRATË JANË TË DISKRIMINUARA GJATË PUNËSIMIT DHE NË VENDIN E PUNËS...

A dakordoheni me pohimin: Gratë kanë tretman të njëjtë me burrat në punë (të përparojnë, pagë të njëjtë, pozicion) sipas gjinisë



Në dallim nga burrat, gjysma (50%) e të cilëve mendojnë se gratë dhe burrat kanë të njëjtin trajtim në punë, vetëm 35, 7% e grave e pohojnë të njëjtën gjë.

Menjëherë e dinë se po të jetë grua, mbase do të marrë leje lindjeje, me burrin janë rehat.“

Unë jam e papunësuar, dhe kur kam vajtur të kërkoj punë, menjëherë më kanë pyetur a jam e martuar, a kam fëmijë, a planifikoj të lindi.“


Për shembull, nëse ke fëmi dhe ai sëmuret, paraqitet problem- përse të përbëjë problem? Përse kjo përgjegjësi nuk kalon mbi burrin, ai të marri ditë të lirë dhe ta çojë fëmijën tek mjeku?“

Dhe jo vetëm për fëmijën, edhe për personat e moshuar në familje, e njëjta gjë ndodh, ajo ngarkesë bie mbi gruan.“

...DHE VEÇANËRISHT PUNONJËSET NË FABRIKAT E TEKSTILIT!

Unë jam e punësuar në një fabrikë tekstili dhe kushtet në të cilat punojmë janë katastrofale... Nuk e njohin ligjin dhe nuk e dinë se punojnë jashtë kohës së duhur, nuk e dinë se u takon leje lindjeje, se u takon pushim dhe e gjithë kjo është keqpërdorur deri na maksimum.“

Punojnë nga 6 muaj dhe pastaj i ç'rregjistrojnë me qëllim që të mos u japin pushim vjetor dhe beneficione të tjera, leje lindjeje....pushime mjeksore të papaguara, d.m.th. gjithçka! Ku është puna jashtë orarit, ajo as që paguhet, e jo më të paguhet si punë jashtë orarit, ndërkohë që në këtë sektor nga gjithë të punësuarit, 90% punojnë gra.“



KONKLUZIONE

- Ekziston rregullativë ligjore e cila mundëson barazi gjinore në tregun e punës, por në realitet ekziston një dallim i madh gjinor në aktivitetin e tregut të punës, distribuim horizontal dhe vertikal në vendet e punës dhe në pagat.
- Në Rajonin e Pollogut përqindjen më të madhe të grave të papunësuar e bëjnë ato të zonave rurale – 43.5%. Të dhënat flasin për ekzistencë të varfërisë gjatë punësimit. E dhëna se 50% e grave të papunësuar në Pollog jetojnë në familje me të ardhura të ulëta e vërteton të ashtuquajturin fenomen të feminizimit të varfërisë. Pothuaj një e treta e familjeve, ku ka një ose dy gra të punësuar, jetojnë me të ardhura mujore deri në 18.000 denarë.
- Gratë janë të vetëdijshme se për ato ekzistojnë kufizime të mëdha gjatë kërkimit të punës në krahasim me ato të burrave. Kushtet dhe mundësitë në shoqëri (mungesa e institucioneve për përkujdesje ndaj fëmijëve dhe personave të moshuar), si dhe diskriminimi dhe trajtimi joadekuat, nuk janë të favorshme për gratë që ato të jenë të pranishme njëjloj si burrat në tregun e punës dhe njëjloj të trajtuara dhe të vlerësuara.
- Sipërmarrja e grave në Pollog ende është në fillimet e saj, edhe pse në të gjitha komunat ekzistojnë aktivitete të caktuara në këtë fushë. Gratë janë bartëse të bizneseve të vogla, të cilat shpesh janë të parregjistruara, dhe për më tepër ndeshen me sfida të ndryshme të cilat i pengojnë në realizimin e biznes – ideve të tyre.

REKOMANDIME

- Përfshirje sistematike e vetëqeverisjes lokale në politikat nacionale për uljen e papunësisë si dhe futjen e masave të tjera të ndërmara nga vetë komuna për uljen e papunësisë së grave, papunësi që buron nga vetë natyra specifike e rajonit na fjalë.
- Ingranimi/ praktikimi i ndjeshmërisë gjinore në zbatimin e masave aktive për punësim, ku kriteret do të garantonin qasje të njëjtë dhe shfrytëzim të mundësive nga ana e grave njëjloj si nga burrat.
- Futja e kriterëve në masat për zvogëlimin e papunësisë për trajtimin e grave nga shtresat më të prekshme sociale, veçanërisht gratë nga zonat rurale si dhe gratë me nivel më të ulët arsimor.
- Zhvillimi i politikave komplementare/plotësuese për planifikimin e masave nëpërmjet të cilave do të sigurohen shërbime (kopshte dhe çerdhe për fëmijë, transport etj..)
- Mobilizimi i grave për shfrytëzimin e mundësive aktuale në programet për zvogëlimin e papunësisë si kontribut të shoqatave të qytetarëve (OJQ-ve).
- Nritja e vetëdijes për praninë e diskriminimit në vendet e punës dhe sensibilizimi për mobingun dhe shqetësimin seksual në vendin e punës.
- Njësitë e vetëqeverisjes lokale të fusim masa speciale për mundësimin e qasjes ndaj shërbimeve sociale bazë dhe të bëjnë prioritetizim në shërbimet e infrastrukturës që janë me interes për gratë e zonave rurale dhe grupeve të marginalizuara.

Projekt: “Barazia dhe Përfaqësimi Gjinor Përtej Kufijve”



Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian



Projekti është implementuar nga Akcija Zdruzhenska Shkup dhe Institutit për zhvillim të komunitetit Tetovë



Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Akcija Zdruzhenska dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian.